



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1039

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “PROGLOBAL” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me uniforma dhe këpucë dimërore” me numër të prokurimit 203-40300-25-6865-1-1-1, me 12/12/2025, mori:

Vendim

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “PROGLOBAL” SH.P.K. me nr. 2025/1039, e datës 20/10/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me uniforma dhe këpucë dimërore” me numër të prokurimit 203-40300-25-6865-1-1-1.

II. Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të “AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS”, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “Furnizim me uniforma dhe këpucë dimërore” me numër të prokurimit 203-40300-25-6865-1-1-1 kthehet në **Rivlerësim**.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

IV. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 31.07.2025, “AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me uniforma dhe këpucë dimërore” me nr. të prokurimit: 203-40300-25-6865-1-1-1. Ndërsa me datën 02.10.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie. LOT II: OE “SOLID” SH.P.K. Gradina- Suharekë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 40,000 €.

Me 07.10.2025, OE “PROGLOBAL” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. E cila me vendimin e AK me datën 10.10.2025 është refuzuar si te pa bazuar Kërkesën për Rishqyrtim.

Me 20/10/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “PROGLOBAL” SH.P.K me nr. 2025/1039 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me uniforma dhe këpucë dimërore” me nr. të prokurimit: 203-40300-25-6865-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “PROGLOBAL” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Te nderuar,

Autoriteti Kontraktues – Agjencia Pyjore e Kosovës, me datën 02.10.2025, ka publikuar formularin B58 – Njoftimin mbi vendimin e AK-se ku, kundërligjshëm është rekomanduar për dhënien e kontratës kompania “Solid” shpk, përderisa kompania jone “PROGLOBAL” shpk është eliminuar si e pa pergjesheshme, me arsyetim kundërligjore dhe atë si me poshtë:

Pretendimi ankimore. 1 Kundër arsytimit te sipër përshkruar te eliminimit dhe kundër propozimit për dhënie te kontratës ne si kompani me datën 07.10.2025, kemi parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, përderisa AK – APK, me datën 10.10.2025, përmes vendimit te saje refuzon kërkesën, ndërsa qe ndaj pretendimeve tona ankimore fare nuk jep përgjigje.

Ligji i Prokurimit Publik, kërkon qartës që një vendim për refuzimin e një kërkesë për rishqyrtim të jetë i arsyetuar dhe ti komunikohet parashtruesit të ankesës.

Vendimi i AK-së, i datës 10.10.2025, mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, përmban vetëm një "Arsyetim" të përgjithshëm, ku potencohet se: “OE PROGLOBAL SH.P.K, me dt. 07.10.2025 ka parashtruar ankesë lidhur me vendimin e AK për shpërbllim me kontratë i dt. 02.10.2025 dhe se Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesën në fjalë, pretendimet ankimore janë të pabazuara dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendos si në dispozitiv.”.

Ky tekst nuk përmban arsyetim konkret dhe ligjor pasi që nuk adreson asnjë pretendim specifik: Kërkesa për rishqyrtim i përmban dy pretendime kryesore të detajuara , duke përfshirë argumentet dhe provat për kualitetin e këpucëve ku ne si kompani jemi eliminuar kundërligjshëm dhe argumentin për mos përmbushjen e standardit EN 20345 nga ana e OE i rekomanduar “Solid shpk”.

Vendimi i AK-së nuk e përmend asnjërin nga këto kundërshtime, as nuk jep shpjegime se pse provat janë të pa bazuara ! Neni 108/A, paragrafi 6, 9 dhe 12, përcaktojnë që kundërshtimet dhe vendimet e miratuara duhet të jenë të arsyetuara dhe të komunikohen me shkrim ankuesit, përkatësisht nuk është shpjeguar arsyetimi ligjor dhe faktik që qëndrojnë pas refuzimit.

Kërkesa për rishqyrtim e OE PROGLOBAL SHPK e datës 07.10.2025 përmbante argumente të detajuara dhe prova që tregonin se, oferta e OE ankues i përmbushte të gjitha Specifikimet Teknike dhe OE i rekomanduar, Solid shpk, është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka ofruar këpucë me standardin e kërkuar EN 20345 (mbrojtje të gishtave) dhe certifikatat e kualitetit.

- Prove: Kërkesa për ri shqyrtim edates 07.10.2025 dhe vendmi i AK- APK i datës. 10.10.2025.

Pretendimi ankimore. 2 Arsytimi i eliminimit të ofertës sonë është në tërësi i pa baze dhe bie ndesh me kërkesat e përcaktuara në Dosje të Tenderit dhe specifikimet teknike të detyrueshme si rrjedhojë këpucët e ofruara nga PROGLOBAL SHPK, modeli VESUVIO WINTER, plotësojnë të gjitha Specifikimet teknike të Aneksi 1 të TD, dhe janë me të avancuara duke ofruar siguri shumë më të lartë se sa është kërkuar në TD. Nga katalogu i ofruar, lehtësisht mund të konstatohet se këpucët tona janë:

Çizme dimërore prej lëkure të fortë me rreshtim Thinsulate 200 dhe shputë të jashtme PU/gome, për kushte ekstreme. Në pjesën e sipërme të brendshme të izoluar me Thinsulate 200 - material shumë i butë për ngrohtësi dhe rehati. Në pjesë të sipërme prej lëkure të plotë dhe një shputë të jashtme BASF PU/gome të fortë, ajo siguron kapje dhe tërheqje të shkëlqyer, përveç tjerave edhe në mjedise me akull.

- Pjesa e sipërme e jashtme: Lëkurë - Rreshtimi i brendshëm : 3M Thinsulate (e butë)

- Shtesë këmbësh: Dimërore me shkumë SJ

- Shtesë e mesme: Shputë tekstili kundër shpimit

- Gomë në pjesën e poshtme: PU BASF (NBR)

- Çelik për mbrojtjen e gishtërinjve

- Kategoria SR, SC, HI, CI, FO, HRO

Pjesa e sipërme e jashtme prej lëkure natyrale që merr frymë dhe ofron një shkallë të lartë rehatie Këpucët e sigurisë të izoluar nga të ftohtit (CI) i mbajnë e ngrohta. Shtojca e jashtme shputat prej gome, i bëjnë të përshtatshme për shumë fusha aplikimi: rezistencë të shkëlqyer ndaj prerjeve, rezistencë ndaj nxehtësisë dhe të ftohtit, fleksibilitet të lartë në temperatura të ftohta, rezistencë ndaj vajit, karburantit dhe shumë kimikateve.

Shtojca rezistente ndaj nxehtësisë (HRO) - Shputa i reziston temperaturave të larta deri në 300°C. Mbulesë mbrojtëse (SC) - Material i testuar veçmas për të mbuluar zonën e gishtërinjve të këmbës për të zvogëluar gërryerjen e materialit të sipërm. Certifikuar me standard EN 20345:2022, Certificate No.:

ITASLNB24025091

Këpucët e ofruara nga PROGLOBAL përveç se plotësojnë të gjitha specifikat teknike të Aneksi 1, përfshi Standardin EN 20345 (shih: Catalogun, EU TYPEEXAMINATION CERTIFICATE, EU Declaration of Conformity in accordance with Regulation (EU) 2016/425 dhe CERTIFICATE OF ACCREDITATION) pjesë e ofertës, sikurse është kërkuar dhe në TD.

- Prova 1 – Proglobal - EN 20345 Certifikata Këpucët janë me të avancuara për nivel të mbrojtjes me:

- Cl - të izoluara nga të ftohtit

- Hl - lëkure natyrale që merr frymë

- FO – rezistente ndaj hidrokarbureve

- HRO – rezistencë ndaj nxehtësisë

Këpucët e ofruara nga PROGLOBAL SHPK, sikurse është kërkuar në TD kanë etiketën me të dhënat, përfshi: Madhësinë e këpucës (43), Standardin që plotëson këpuca (EN 20345), Shenjen e prodhuesit (SAFETY JOGGER), Shenjen e tregut evropian (CE), Vitin e prodhimit (07/2024)

Prove: Foto etiketa në këpucë:

AK, ofertën tone tenton ta eliminojë si të pa përgjegjshme dhe me këtë të keqpërdor parandë publike, meqenëse edhe oferta është me e lire. Këpucët tona i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Dosje të Tenderit dhe Specifikacione teknike të detyrueshme, si rrjedhojë arsyetimi i eliminimit nuk ka kurrfarë lidhje me dispozita ligjore apo specifika teknike. Neni 52.3 lidhur me nenin 56.3 të LPP-se përcakton:

“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Pretendimi ankimore 2 AK në Aneksi 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme, ka kërkuar që këpucët të jenë: Ngjyrë të zezë ose kafe; Të punuara me material 100 % lëkurë; Të kenë besueshmëri për terren, me 1 vit Garanci për rezistencë ndaj ujit dhe defekteve të fabrikës; Ndërlidhja rezistente ndaj gërryerjes; Fundi / shputat me mbështjellje gome, të pa-rrëshqitshme dhe të fort; Këpucë duhet të jenë për ecje të gjata në terrene pyjore të vështira dhe me gurë. Materiali duhet të jetë i papërshkueshëm nga kushtet më ekstreme (borë, shi, ngrica etj.).

• Etiketat të përmbajtjes dhe cilësisë duhet të ketë minimum shënimet si: madhësinë e këpucës, standardin që plotëson këpuca shenjen e prodhuesit dhe shenjen e tregut evropian CE, vitin e prodhimit etj, sipas përshkrimit të kërkuar. • Në përputhje me kërkesat e Direktivës Evropiane 89/686, të veçantë për ergonomi, rehati, fleksibilitet si dhe Standardet Europiane EN344-1 dhe EN345-1 ose EN 20345-2011 S1, SRC; • Së bashku me ofertë të dorëzohen mostra dhe certifikatat / deklaratat e konfirmimit të materialit* ose tiketa e prodhuesit me të dhëna të jetë e ngjitur . OE i propozuar për kontratë Solid nuk plotëson kushtet e Aneksi 1 të TD 1. Nuk ka ofruar këpucë sipas standardit EN 20345 që nënkupton se duhet të kenë mbrojtje të gishtërinjve Ky standard përfshinë dhe nivelin e mbrojtjes së këpucëve të sigurisë, për: rezistente ndaj ujit, rezistente ndaj gërryerjes, të pa-rrëshqitshme. 2. Mostrat e dorëzuara nuk kanë: Etiketën e përmbajtjes dhe cilësisë duhet të ketë minimum shënimet si: madhësinë e këpucës, standardin

që plotëson këpuca shenjen e prodhuesit dhe shenjen e tregut evropian CE, vitin e prodhimit etj, sipas përshkrimit të kërkuar.

3. Nuk ka dorëzua Certifikatën e kualitetit EN 20345 4. OE Solid me oferte ka dorëzua dokumentin ISO Standard - STANDARD KOSOVAR SK EN 20345, qe shpjegon standardin, por nuk ka te beje fare me produktin qe ka ofru OE Solid Prova 2 – Solid - STANDARD KOSOVAR SK EN 20345 Ku përshkruhet standardi EN 20345 qe zbatohet ne EU, kushtet qe duhet te plotësoje një produkt (mbathje) sa i përket nivelin e sigurisë. Ky dokument nuk ka te beje me kriteret e përcaktuara nga AK. Ne TD është kerku - Së bashku me ofertë të dorëzohen mostra dhe certifikatat

Certifikata e kualitetit EN 20345 përmban:

- Emrin dhe adresën e prodhuesit
- Numri i Certifikatës se lëshuar
- Emri i brendit
- Artikulli / kodi i këpucës
- Standardi
- Nivelet e sigurise - Data e skadence

Këtë Certifikate EN 20345 nuk e ka ofru OE i propozuar për kontrate Solid Nuk ka dorezu Certifikatën e akreditimit te laboratorit sipas ISO/IEC Standard 17025:2017 Nga foto shihet se këpucët nuk plotësojnë standardin EN 20345 (për mbrojtje dhe te gishterinjve) Këpucët kur janë me mbrojtëse te gishterinjve sipas EN 20345 nuk ka mundësi te shtypen lehtësisht vetëm me dore (shih foto) sepse duhet te përballojnë goditje deri 200 J.

Përfundim: Operatori Ekonomik i propozuar për kontrate NUK është i përgjegjshëm dhe si i tille do te duhej te eliminohej si i pa përgjegjshëm.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “PROGLOBAL” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, Neni 27 Dosja e Tenderit, Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës, Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mos marreveshjeve, Rregullorja me nr 001/2022, per Prokruim Publik, Neni 17 Dosja e Tenderit, Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve Neni 97 Shkeljet e rënda. Prandaj bazuar në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik të konstatuara dhe te argumentuara si me sipër, OE ankues, kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe zyrtaret autorizues që, në zbatim të nenit 113 të LPP-së, të autorizojë ekspert shqyrtues profesional dhe të paanshëm ne atë mënyrë qe pretendimet ankimore të paraqitura nga OE ankues, si rrjedhoje OSHP të marrë masa që të mos caktohen ekspertë shqyrtues – profesional nga lista e jashtme, të cilët janë të punësuar si zyrtarë aktivë në autoritetet e ndryshme kontraktuese, duke marrë parasysh se një praktikë e tillë rrezikon ndikimin dhe përfshirjen në konflikt te mundeshem te interesit, në dëm të parimeve të prokurimit publik dhe dem te kompanis sonë, ne atë mënyrë qe Paneli Shqyrtues i OSHP-së të nxjerrë këtë: V E N D I M I. Aprovohet Kërkesa për Ankesë e Operatorit Ekonomik "PROGLOBAL" SHPK si e bazuar; II. Anullohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 02.10.2025 si i kundërligjshëm, dhe lënda të kthehet në rivlerësim; III. Lejohet kthimi i

mjeteve të depozituara në emër të tarifës së ankesës, në përputhje me nenin 118 të LPP-së.

Përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim: I. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për Rishqyrtim e OE PROGLOBAL SH.P.K., me seli në adresën 28 Nëntori nr. 129, 10000, Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me uniforma dhe këpucë dimërore(Lot/pjesa-2 këpucë dimërore) me nr. te prokurimit: 203-40300-25-6865-1-1-1 & Numri i brendshëm: 40300-25-01 1-111 e iniciuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës.

II. Vërtetohet Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues Agjencia Pyjore e Kosovës lidhur me Furnizim me uniforma dhe këpucë dimërore(Lot/pjesa-2 këpucë dimërore) me nr. te prokurimit: 203-40300-25-6865-1-1-1 & Numri i brendshëm: 40300-25-011-111.

III. Autorizohet: Autoriteti Kontraktues Agjencia Pyjore e Kosovës të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën ka marrë një vendim.

IV. Obligohet : Autoriteti Kontraktues -Agjencia Pyjore e Kosovës qe refuzimin e ri-shqyrtimit te ju komunikohet parashtruesit te ankesës dhe te gjitha palëve te interesuara.

V. Vendimi hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit OE PROGLOBAL SH.P.K., me seli në adresën 28 Nëntori nr.129, 10000, Prishtinë, me dt:07.10.2025 ka parashtruar ankesë lidhur me vendimin e AK për shpërblim me kontratë i dt: 02.10.2025 lidhur me aktivitetin e Furnizim me uniforma dhe këpucë dimërore(Lot/pjesa-2 këpucë dimërore) me nr. te prokurimit: 203-40300-25-6865-1 -1 -1 & Numri i brendshëm: 40300-25-011-111.

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesën në fjalë , pretendimet ankimore janë të pabazuara dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendos si në dispozitiv.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 23.10.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1039/2025, ndërsa me datë 31.10.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 1039/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet rreth rekomandimit te ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertes, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "PROGLOBAL" SH.P.K ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1039 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi ankimore 1.

OE ankues ne pretendimin e para ankimore pretendon se AK - APK, ne vendimin ndaj kërkesës për ri shqyrtim nuk i është përgjigjur OE sipas dispozitave ligjore te nenit 108/A te LPP-se.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues, ne kërkesën për ri shqyrtim ka ngritur pretendime ankimore ndaj eliminimit dhe ndaj kompanisë se rekomanduar për dhënien e kontratës. AK - APK, ne vendimin e datës 10.10.2025, sipas vendimin ka refuzuar kërkesën pe ri shqyrtim dhe ne arsyetimin këtij vendim potencon se OE Proglobal shpk ka paraqit kërkesë për ri shqyrtim dhe ak e ka shqyrtuar kërkesën ne fjale dhe pretendimet ankimore janë te pa bazuara. Si rrjedhoje AK nuk e ka arsyetuar me prova dhe fakte pa përgjegjshmërinë e OE ankues dhe me këtë nuk i ka respektuar dispozitat ligjore te nenit 108/A te LPP-se nenin 12 ku përcaktohet qe: "Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.", prandaj këtë pretendim ankimor e kualifikojmë si te bazuar pasi qe AK nuk i është pergjithur pretendimeve ankimore.

Pretendim ankimor 2.

OE ankues pretendon se arsyetimi i eliminimit është i pa bazuar pasi qe arsyetimi i eliminimit te ofertës është ne tërësi i pa baze dhe bie ndesh me kërkesat e përcaktuara ne dosje te tenderit dhe specifikimet teknike te detyrueshme.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues sipas letrës standarde është eliminuar për këtë arsye:

Eksperti shqyrtues vlerëson se arsyetimi i eliminimit te kompanisë ankuese nuk korrespondon me kërkesat ligjore te përcaktuara ne FDT apo ne specifika teknike te detyrueshme, si rrjedhoje e kesaje AK si arsyetimet e elemimit ka potencuar se këpucët dimërore sipas komisionit vlerësues te ofertave nuk janë te pershtateshme, materiali i rende apo jo te përshtatshme për teren malore dhe se modeli i kepuceve nuk është i perlqyeshem për pylltari. Eksperti shqyrtues sqaron se AK për kepuce dimerore ne anelsin 1 te dosjes se tenderit ka përcaktuar specifika teknike për këto produkte dhe se AK ne arsyetim te eliminimit nuk ka potencuar se OE, përkatësisht këpuca nuk e plotëson ndonjëren nga specifikat, ndërsa modeli dizajni apo edhe pershtatshmeria dhe pesha nuk janë te përcaktuara se kërkesa kualifikuese apo specifike ne aneksin 1 te dosjes se tenderit prandaj edhe këtë pretendim ankimore e vleresojme si te bazuar pasi qe AK – APK, e ka eliminuar kompaninë ne kundërshtim me nenit 52.3 dhe nenin 56.3 te LPP-se pra është eliminuar për kërkesa te cilat nuk kane qene pjese e kërkesës se dosjes se tenderit.

OE ankues ne ankese ka bashkangjitur prova këpucët e prezantuara si mostra fotografi te tyre dhe specifikat teknike përmes te cilave konfirmohet se produktet janë sipas kërkesave te AK-se.

Pretendim ankimore 3:

Operatori Ekonomik, ankues pretendon se OE i rekomanduar për dhënien e kontratës nuk i plotëson kushtet e aneksit 1 te specifikave teknike te detyrueshme pasi qe nuk ka ofruar këpucë sipas standardit EN 20345 për mbrojtje nga gishterinjeve.

Eksperti shqyrtues sqaron se Ak ne dosjen e tenderit tek specifikat teknike te detyrueshme ka kerkuar:

Në përputhje me kërkesat e Direktivës Evropiane 89/686, të veçantë për ergonomi, rehati, fleksibilitet si dhe Standardet Europiane EN344-1 dhe EN345-1 ose EN 20345-2011 S1, SRC;

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për dhenien e kontratës ne oferte ka prezantuar

Shkresën – dokumentin e Standardit Kosovare: SK EN ISO 20345:2013)

Ky dokument është standardi Kosovar, për Pajisjet Mbrojtëse Personale - Këpucët e Sigurisë.

Kërkesa e AK-së kërkon standardin EN 20345:2011 dhe se kërkesa e AK, kërkon dëshmi se këpuca e ofruar është në përputhje me standardin EN 20345-2011 S1, SRC, prandaj pretendimin ankimore e vlerësojmë si te bazuar pasi qe OE i propozuar për kontrate nuk ka prezantuar ne oferte dëshmi lidhur me kërkesën e AK-se.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim për AK i cili obligohet të veproj në harmoni me rekomandimet e ekspertëve shqyrtues/teknik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Furnizim me uniforma dhe këpucë dimërore” me nr. të prokurimit: 203-40300-25-6865-1-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “PROGLOBAL” SH.P.K dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e

operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “PROGLOBAL” SH.P.K janë pjesërisht të bazuara.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Furnizim me uniforma dhe këpucë dimërore” me nr. të prokurimit: 203-40300-25-6865-1-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS**
- **OE - PROGLOBAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: